



Republika e Kosovës
Republika Kosova/Republic of Kosovo
Kuvendi Komunal Dragash/Skupština Opštine Dragash/Dragas Municipality

- Kuvendi komunal
O1 Br.06-4240/2
Dt.20.03.2014
D r a g a s h

Në bazë të nenit 17 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale dhe të nenit 32.2 të Statutit të komunës- Dragash, në seancën e Kuvendit Komunal të Dragashit të dt.20.03.2014, pas shqyrtimit paraprak, miratohet ky:

V E N D I M

- I. **MIRATOHET** Plani Lokal i Veprimit në Mjedis për Komunën e Dragashit 2013-2018, si projekt i Qendrës Rajonale të Mjedisit (REC)-Zyra në Kosovë të mbështetur me kontribut nga Trupi Koordinues Komunal dhe një numër subjektsh e individësh, të përfshirë në këtë Plan.
- II. Për implementimin e këtij Plani **OBLIGOHEN** drejtoratet e komunës-Dragash.
- III. Për veprimet ndërmarra të njoftohet Kuvendi Komunal dhe kryetari i komunës-Dragash.
- IV. Ky Vendim hynë në fuqi nga dita e miratimit.

Arsyetim

Plani është hartuar në bazë të angazhimeve të subjekteve dhe individëve të sipërpërmendura në pikën I të këtij Vendimi dhe si i këtillë do të shërben si dokument zhvillimor për terrenin e komunës së Dragashit dhe të gjitha lëmit jetësore të përfshira në këtë dokument, për periudhën e cekur 5-vjeçare.

Dokumenti është i mirëserdhur për komunën e Dragashit, nga se si i tillë paraqet bazë e fortë për përmirësimin e veprimeve në mjedis, forcimin e bazës ekonomike të Komunës së Dragashit dhe jetës së qytetarëve të saj, me mundësi për t'u implementuar projektet e parapara nga investitorët-donatorët, ministritë e Republikës së Kosovës, të hyrat e komunës së Dragashit dhe investitorë tjerë potencial.

I dërgohet:

- Qendrës Rajonale të Mjedisit (REC) – Zyra në Kosovë (Prishtinë),
- Drejtorateve të komunës-Dragash,
- Kryetarit të Komunës-Dragash z.Salim Jenuzi, dhe
- Arkivit

KUVENDIKOMUNAL- DRAGASH

Kryesuesi

Shaban Shabani

